

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE

“ SIRATAL ” Shpk

Sot më date 24 / 03 / 2022, unë i nënshkruari:

z.Fatos Bitaj, i datëlindjes 13.09.1979, lindur ne Sevaster ,Shqipëri dhe banues në Tirane, shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “ **SIRATAL ” sh.p.k.** si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria “ **SIRATAL ” shpk**, nga këtu e mëposhtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

2. Ortaku i vetëm themelues

Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë është **z.Fatos Bitaj**.

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**SIRATAL ” sh.p.k.** do të jetë:

- Punime suvatimi,armature ,hekurkthyes,pllaka,murature,parket,hidrosanitare,elektrike.
- Punime ne ndërtim në objekte të ndryshme ndertimi,godina banimi dhe sherbimi,resorte turistike,rruge,kanalizime,ujesjellsa,vepra arti,diga,mbrojtje kundër zjarrit.Investim ne ndërtim. Dhenie me qera te ambienteve.
- Import – eksport mallra industrial,ushqimor,bimesh medicinale farmaceutike,fruta perime.
- Shitje me shumice dhe pakice te materialeve te ndertimit,artikuj industrial,ushqimore,mobileri,pasticeri,kancelari ,elektroshtepiake.

4. Selia e shoqërisë

4.1 Selia e Shoqërisë “**SIRATAL ” sh.p.k.** do të jetë në Tiranë, në adresën: Rexhep Shala,godine private nr 77,zk 3866 . Yzberisht –Tirane.

4.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë



Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë 20 (njezet) vjeçare, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Afati i përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të shkurtohet apo zgjatet me vendim të ortakut të vetëm, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky Statut.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “**SIRATAL**” sh.p.k. është 100.000 (njeqind mijë) Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Ortakut të vetëm**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

7. Ortaku i vetëm

Ortaku i Vetëm ushtron kompetencat që ligji i jep Asamblesë së Otakëve.

8. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë “**SIRATAL**” sh.p.k. është z.**Fatos Bitaj**.

Administratori emërohet me vendim të Ortakut të vetëm, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “**SIRATAL**” sh.p.k. në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njej ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

9. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Themeluesi

Fatos Bitaj

